

Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimi i punonjësit e institucioneve, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, të cilët, me veprime apo mosveprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, si dhe njëkohësisht zhvillimi i projekteve dhe i programeve në fushën kundër korrupsionit, planifikimi, koordinimi e përcaktimi i instrumenteve të domosdoshme për implementimin e politikave të fushës kundër korrupsionit.

Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrimin të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministria e Drejtësisë në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

Aktivitetet përgjatë muajit Shkurt, 2023

Antikorrupsioni çon në prokurori zyrtarë publikë për shpërdorim detyre

01-27.02.2023: Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion në bashkëpunim me Rrjetin e Koordinatorëve Antikorrupsion ka administruar dhe kryer veprime inspektimi për 27 raste ankesash dhe denoncimesh për korrupsion. Veprimtaria e institucioneve si Agjencia Shtetërore e Kadastrës (drejtoritë vendore të saj), Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, etj, janë kontrolluar nga inspektorët dhe koordinatorët antikorrupsion mbështetur në ankesa dhe denoncime të ardhura në rrugë zyrtare me shkrim (17 raste) dhe në adresën elektronike (10 raste). Pas verifikimeve të kryera janë gjetur dyshime të arsyeshme për kryerjen e veprës penale të shpërdorimit të detyrës (neni 248 KP) për 5 zyrtarë dhe 1 titullar për të cilët është proceduar me kallëzim penal pranë organeve ligjzbatuese, janë propozuar 5 masa disiplinore "largim nga detyra", 6 masa për fillim të ecurisë disiplinore si dhe 2 rekomandime. Të tjera raste hetimi administrativ pranë institucioneve ku është i vendosur Rrjeti i Koordinatorëve kundër Korrupsionit, janë në proces. Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion ka nisur gjithashtu procesin e përgatitjes së analizës së riskut për të gjitha institucionet pjesë e veprimtarisë së Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit, një vlerësim që pritet të përfundojë në muajt në vijim, dhe që do të ofrojë një opinion profesional të rëndësishëm për sektorët ku korrupsioni është më i shtuar.

Denonconi raste dhe praktika abuzive në: koordinatoriak@drejtesia.gov.al



Plani i Integritetit 2022: Parimet e llogaridhënies të zbatuara dhe me transparencë

20.02.2023: Plani i Integritetit të Ministrisë së Drejtësisë, një instrument institucional i luftës kundër korrupsionit përbën një evidencë të shtuar që institucioni ofron më shumë llogaridhënie, transparencë, veprimtari sipas ligjit dhe rregullave. Raporti i monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit për vitin 2022, me të gjithë informacionin për ndjekjen dhe plotësimin e mungesave të evidentuara në kohën e vlerësimit të riskut të integritetit institucional, jep të dhëna dhe shifra për zbatimin e kuadrit rregullator mbi aspekte të integritetit dhe veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë, kapacitetet institucionale për t'i rezistuar shkeljeve të integritetit si dhe çështje të organizimit dhe funksionimit të strukturave teknike. Raporti i monitorimit vlerëson se për 16 masa, 13 masa janë zbatuar plotësisht, 2 kanë mbetur në proces zbatimi dhe 1 e pazbatuar. Gjatë vitit 2022, Ministria e Drejtësisë ka plotësuar kuadrin rregullator për etikën dhe integritetin, ofron transparencë të shtuar të institucionit në publikimin dhe njoftimin e kuadrit ligjor, konsultimin publik, raporteve të performancës dhe ato të auditimit (të brendshëm dhe të jashtëm), trajnime dhe kapacitete të shtuara profesionale për nivelin e ekspertizës së ofruar (legjislative-inspektuese në fushën e shërbimeve të drejtësisë-politikëbërjes) dhe të planifikimit strategjik dhe operacional për shërbimet e ofruara. Plotësimi i vakancave në organikë dhe analizimi i nevojave për kualitete në staf, mbeten një objektivi për t'u kryer në vitin në vijim.

Më shumë informacion në link: https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2023/02/Raport-Monitorimi_-PI-MD_-2022.pdf

Edukimi dhe ndërgjegjësimi kundër korrupsionit si angazhim primar i Partneritetit për Qeverisje të Hapur (OGP), 2022-2024

21-24.02.2023: Edukimi dhe ndërgjegjësimi i publikut të gjerë për mekanizmat e luftës kundër korrupsionit do të jetë fusha e angazhimit për tre vitet 2022-2023-2024 të Partneritetit për Qeverisje të Hapur, për Ministrinë e Drejtësisë, për fushën e përgjegjësisë antikorrupsion. Kjo iniciativë bëri bashkë Drejtorinë Antikorrupsion dhe organizata të shoqërisë civile për të bashkë-planifikuar masa dhe aktivitete që do të rrisin qasjen dhe forcojnë perceptimin e publikut dhe të grupeve të ndryshme të interesit për përdorimin e mekanizmeve antikorrupsion. Ministria e Drejtësisë zhvilloi 2 tryeza diskutimi pune për të bashkë-hartuar dhe konsoliduar përmbajtjen e Planit të Veprimit për Partneritet për Qeverisje të Hapur (OGP), 2022-2024. Masa dhe aktivitete që lidhen me (I) Ndërgjegjësimin e publikut të gjerë mbi mekanizmat në luftën kundër korrupsionit, (II) Edukimin e publikut të gjerë mbi mekanizmat në luftën kundër korrupsionit, dhe (III) Edukimin dhe ndërgjegjësimin e administratës publike për kuadrin ligjor dhe rregullator për antikorrupsionin dhe mekanizmat antikorrupsion në sektorin publik, do të jenë në zbatim nga strukturat antikorrupsion dhe organizatat e shoqërisë civile aktive në këtë sektor. Plani i Veprimit përbëhet gjithsej nga 17 masa, nga të cilat 9 masa janë për zbatim direkt nga Ministria e Drejtësisë dhe 8 masa të tjera, të cilat do të udhëhiqen në zbatim nga shoqëria civile, nga IDM dhe ALTRI. Botime antikorrupsion, video dhe mjete komunikimi, e-buletine, forcim kapacitetesh, manuale hetimi, metodologji monitorimi, instrumente integriteti, etj, janë disa prej masave të planifikuara në këtë plan veprimi.

Konsultoni dhe merrni informacion për Planin Kombëtar për Qeverisje të Hapur, në: <https://ogp.gov.al/>



Shqipëria fiton 4 vende në renditjen botërore të Indeksit të Demokracisë, 2022

02.02.2023: Raporti "Indeksi i Demokracisë" 2022 rendit në vendin e 64-t Shqipërinë, nga 165 vende të botës. Raporti prodhohet dhe publikohet nga Njësia e Inteligjencës Ekonomike (EIU), prej vitit 2006, që është njëkohësisht edhe një prej tetë raporteve ku mbështetet Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit të *Transparency International*. Për vitin 2022, Shqipëria ka fituar 4 vende në renditjen botërore (vendi 64-t me 6.41 pikë). Indeksi i Demokracisë 2022 merr në vlerësim pesë faktorë, të lidhur ngushtë me shtetin ligjor dhe parimet demokratike, përmenden: (I) procesi zgjedhor dhe pluralizmi; (II) funksionimi i qeverisë; (III) pjesëmarrja politike; (IV) kultura politike dhe (V) liritë civile. Me këtë pikëzim (6.41), Shqipëria ka marrë një rezultat më të lartë sesa mesatarja e Rajonit të Evropës Lindore 5.39 pikë, si dhe një tendencë më pozitive në krahasim me shtetet e Ballkanit Perëndimor. Në këtë vlerësim, janë marrë disa burime të rëndësishme informacioni, si sondazhet e opinionit publik, pjesëmarrja në votime dhe funksionimi i organeve legjislative dhe atyre ekzekutive dhe jep një pamje të përgjithshme të gjendjes së demokracisë dhe zbatimit të saj.



Bashkimi Evropian asistencë të shtuar teknike për strukturat e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

07.02.2023: Delegacioni i Bashkimit Evropian në Tiranë ka mbyllur pas tre vitesh zbatimin e projektit të Asistencës Teknike për Koordinatorin Kombëtar Kundër Korrupsionit. Në një aktivitet të hapur me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve qeveritare, institucione të pavarura, organizatave jo-qeveritare dhe partnerë të huaj në Tiranë, u deklarua i përfunduar një prej projekteve që kanë asistuar kapacitetet teknike dhe profesionale të Ministrisë së Drejtësisë për veprimtarinë antikorrupsion. Zëvendësministri i Drejtësisë znj. Pirdeni dhe Shefi i Operacioneve të Delegacionit të Bashkimit Evropian, znj. Vitkova, vlerësuan mbështetjen e dhënë nga ekspertiza teknike e projektit referuar kapaciteteve të planifikimit dhe programimit strategjik, konceptimit të masave dhe angazhimeve praktike, aftësive të shtuara të vizibilitetit dhe komunikimit me publikun, ekspertizës kërkimore dhe analitike dhe vendosjes së dialogut të rregullt me OSHC-të dhe institutet kërkimore të *think-tank-ëve*. Projekti i Asistencës Teknike i Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë ka asistuar Koordinatorin Kombëtar Kundër Korrupsionit, prej shkurtit 2020 deri në janar 2023, duke dhënë një kontribut në përmirësimin e mekanizmave dhe strukturave institucionale e teknike antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë.



Fushatë ndërgjegjësimi online “Denonco korrupsionin”

2-28.02.2023: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë, ka kryer një fushatë intensive komunikimi dhe vizibiliteti, për të afruar publikun në luftën kundër korrupsionit. Në profilet sociale dhe rrjetet e komunikimit të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion, Facebook, Twitter dhe LinkedIn, janë shfaqur një seri videosh udhëzuese dhe ndërgjegjësuese për të denoncuar praktikën dhe abuzimet në institucionet publike, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion. 15 video informuese për qytetarët për mekanizmin e raportimit të rasteve të dyshuara të korrupsionit, pranë koordinatorëve kundër korrupsionit janë publikuar dhe mund të aksesohen në çdo kohë. Kjo fushatë ndërgjegjësimi kundër korrupsionit ka shfrytëzuar mjete të komunikimit elektronik për të krijuar partneritet me publikun, ndërveprim dhe vëmendje të shtuar në adresimin e rasteve korruptive.



Vizitoni profilet sociale të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion në: Facebook; LinkedIn, Twitter

